- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja

e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
  - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Kualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	



**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

Data: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: \_\_\_\_\_

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):  
\_\_\_\_\_

Monedha: \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>		
<b>Arti kulli</b>	<b>Përshkrimi i shërbimit</b>	<b>Sasia (Muaj)</b>	<b>Sasia (nr.vendroje)</b>	<b>Numri total i rojeve për vendroje</b>	<b>Çmimi Njësi /muaj</b>	<b>Çmimi total për shërbim</b>
1.	<i>Shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare për Njësinë e Koordinimit Burrel FSHU Sh.A (Turni I-<sup>rë</sup>, nga ora 14.<sup>00</sup> - 16.<sup>00</sup> për 12 njësi nga e Hëna deri ditën e Shtunë)</i>	(24)	(12)	(3)		
2.	<i>Shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare për Njësinë e Koordinimit Burrel FSHU Sh.A (Turni II-<sup>të</sup>, nga ora 20.<sup>00</sup> - 21.<sup>00</sup> për 6 njësi, nga e Hëna deri ditën e Shtunë)</i>	(24)	(6)	(3)		
				<b>Çmimi total</b>	_____	

<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>	
<b>TVSH (%)</b>	
<b>Çmimi total me TVSH:</b>	
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

### Sqarime:

1. Në çmim të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet për detyrimet fiskale që parashikon kuadri ligjor dhe nën ligjore në fuqi në lidhje me këtë shërbim që ka të bëjë me pagat, shtesat mbi pagë për turnet e II-ta, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet për karburantin, shpenzimet për autorizimet e autobllindave, shpenzimet administrative si dhe fitimi i shoqërisë, etj.
2. Bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi për 1 njësi me shërbim (Turni I-rë, nga ora 14:00 - 16:00) dhe 1 njësi me shërbim (Turni II-të, nga ora 20:00 - 21:00) nga e Hëna deri të Shtunë, me koeficient (3) punonjës. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizën e kostos mujore të kryerjes së shërbimit.

Preventiv të koston për 1 njësi në muaj për 2 orë shërbim transporti me 3 punonjës për Turni I-rë

<b>Nr.</b>	<b>Kosto Shërbim Shoqërimi</b>	
A	Paga bazë mujore për 3 punonjës	
	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7%	
	Total shuma	
B	Shpenzime administrative të shoqërisë	
	Total shuma	
C	Shpenzimet e Transportit	
	Karburant për Autobllindat për 18 km	
	Taksat e Siguracionet e Autobllindave	
	Mirmbajtje të Autobllindave	
	Shpenzime për Autorizimet e Autobllindave	
	Total Shuma	
D	Fitimi i shoqërisë	
	Total Shuma	
	<b>TOTALI A+B+C+D</b>	

Preventiv të kostos për 1 njësi në muaj për 1 orë shërbim transporti me 3 punonjës për Turni II-të

Nr.	Kosto Shërbim Shoqërimi	
A	Paga bazë mujore për 3 punonjës	
	Shtesat për Turn II-të	
	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7%	
	Total shuma	
B	Shpenzime administrative të shoqërisë	
	Total shuma	
C	Shpenzimet e Transportit	
	Karburant për Autoblindat për 8 km	
	Taksat e Siguracionet e Autoblindave	
	Mirmbajtje të Autoblindave	
	Shpenzime për Autorizimet e Autoblindave	
	Total Shuma	
D	Fitimi i shoqërisë	
	Total Shuma	
	<b>TOTALI A+B+C+D</b>	

**SHËNIM:** Operatorët ekonomikë krahas Formularit të Ofertës dhe preventivit të publikuar në DST duhet të paraqes edhe:

- Analizën e Çmimit me përlllogaritje konkrete aritmetike, në të cilën të jenë përfshirë të gjitha detyrimet ligjore si:
  - Shpenzime për pagë bazë,
  - Shtesë mbi pagë për turnin II,
  - Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%,
  - Shpenzime administrative të shoqërisë
  - Karburant për Autoblindat
  - Taksat e Siguracionet e Autoblindave
  - Mirmbajtje të Autoblindave
  - Shpenzime për Autorizimet e Autoblindave
  - Fitimi i shoqërisë.

\* Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit dhe analizës së kostos, rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar apo të pa llogjikshme ekonomikisht, do të s'kualifikohen.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka të drejtë t'u kërkojë operatorëve ekonomik sqarime në lidhje me zërat e ofertës ekonomike dhe në rast se konstaton se operatori nuk e argumenton dot aritmetikisht, ligjërisht dhe me dokumentacion mbështetës ofertën, autoriteti do ta s'kualifikojë.

---

## Analiza e kostos

- Operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë të detyruar të paraqesin preventivin dhe analizën e çmimit sipas parashikimeve të mësipërme sipas zërave të mësipërm, duke pasqyruar të gjitha kostot minimale sipas detyrimeve ligjore në fuqi si VKM-së Nr. 113, datë 01.03.2023 “*Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi*”, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Legjislacionit për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore (në fuqi) dhe Ligjit 75/2014 “*Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike*” dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.
- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një njësi me dy turne është të llogaritet **3** (orë punë/ punonjes/ muaj: **174 orë**).
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit).
  
- **Klasifikimi i ofertave bëhet mbi bazën e vlerës së ofertës së dhënë ne total.**

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

***“Shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare për Njësinë e Koordinimit Burrel FSHU Sh.A”***

### **I. Të realizohet shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare, si më poshtë:**

1. Zyra të Shërbimit ndaj Klientit (**KNK**) (*Peshkopi, Kastriot, Maqellarë, Shupenzë, Bulqizë, Klos, Burrel, Mirditë (Rreshen), Laç, Milot*) deri në bankat përkatëse, dhe **Arkat** (*Rubik, Mamurras*) deri në bankat përkatëse.
2. Grupi i shoqërimit duhet të jetë pajisur me mjete mbrojtëse, me Uniformë dhe Dokument Identifikimi si dhe mjete të tjera logjistike siç parashikohet në Ligjin Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
3. Të ruajë dhe shoqërojë vlerat monetare që i janë besuar dhe të sigurojë jetën e personelit gjatë transportit të vlerave monetare.
4. Për transportin e vlerave monetare, Ofertuesi duhet të pajisë punonjësit e shërbimit me armë krahu, sipas përcaktimeve ligjore të Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe ato nënligjore në zbatim të tij.

### **II. Ofruesi i Shërbimit duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtëm:**

- a) Të jetë i Liçencuar nga autoritetet kompetente për ushtrimin e funksionit si roje i ruajtjes dhe Sigurisë Fizike (**Kopje e Liçencës**)
- b) Të reflektojë një sjellje korrekte dhe të respektueshme .
- c) Mjeti i identifikimit i punonjësve të shërbimit gjatë gjithë kohës së Shërbimit duhet të mbahet në vend të dukshëm.
- d) Gjatë gjithë kohës së Shërbimit punonjësi i kompanisë SHPSF, duhet të respektojë rregullat e brendshme të “FSHU”, Sh.a.
- e) Punonjësi i Ofruesit të Shërbimit duhet të jetë i aftë të reagojë dhe veprojë gjithmonë në përputhje me Instruksionet e personave përgjegjës të përcaktuar nga “FSHU”, Sh.a.
- f) Të gjithë punonjësit e Ofruesit të Shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me Uniformën dhe të gjitha materialet e nevojshme llogjistike sipas Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” të publikuar në Fletoren Zyrtare të datës 08.08.2014, si dhe në Aktet nënligjore përkatëse.
- g) Të kërkojnë nga punonjësit të zbatojnë rregullat e brendshme të Objektit.

- 
- h)** Transporti i mjeteve monetare do të kryhet sipas shpërndarjes së objekteve dhe grafikut të ekzekutimit të përcaktuar në tabelën e *Shtojcës Nr. 6*.
- i)** Transporti do të kryhet në përputhje me Legjislacionin në fuqi.
- j)** Mjetet dhe numri i punonjësve që do të kryejnë shërbimin e transportit të vlerave monetare do të bëhet në përputhje me Legjislacionin në fuqi.
- k)** Shoqërimi i vlerave monetare do të kryhet një ose dy herë në ditë, sipas instruksioneve të personave përgjegjës të “FSHU”, Sh.a.
- l)** Oraret e lëvizjes do të jenë: Koha orare e shoqërimit të vlerave monetare do të jetë :
- Turni i parë nga ora 14:<sup>00</sup> - 16:<sup>00</sup>
  - Turni i dytë nga ora 20:<sup>00</sup> - 21:<sup>00</sup>
- m)** Shoqërimi do të kryhet nga dita e Hënë deri ditën e Shtunë në të gjitha pikat sipas tabelës dhe përcaktimeve në *shtojcën Nr. 6*.
- n)** Shoqërimi duhet të kryhet me mjetet e shoqërisë së shoqërimit, mjete duhet të jetë i blinduar, i loguar, në gjendje të rregullt teknike dhe dokumentare për kryejn e ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare.



(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

## FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **“Shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare për Njësinë e Koordinimit Burrel FSHU Sh.A”, sipas tabelës së mëposhtme:**

Nr.		Shpërndarja	Shërbimi	
1.	<b>Zona Burrel</b>	Bulqizë KNK	Turni i I-rë	Turni i II-të
2.		Maqellarë KNK	Turni i I-rë	
3.		Milot KNK	Turni i I-rë	
4.		Shupenzë KNK	Turni i I-rë	
5.		Burrel KNK	Turni i I-rë	Turni i II-të
6.		Klos KNK	Turni i I-rë	Turni i II-të
7.		Rubik Arkë	Turni i I-rë	
8.		Mamurras Arkë	Turni i I-rë	
9.		Kastriot KNK	Turni i I-rë	
10.		Laç KNK	Turni i I-rë	Turni i II-të
11.		Mirditë KNK	Turni i I-rë	Turni i II-të
12.		Peshkopi KNK	Turni i I-rë	Turni i II-të

### Afatet e ekzekutimit:

Ekzekutimi i kontratës do të fillojë me nënshkrimin e kontratave, deri në përfundimin e afatit **24** (njëzet e katër) **mujor**.

---

## Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

#### **Objekti dhe Qëllimi i Shërbimeve**

Ofruesi i Shërbimit do të bëjë ruajtjen dhe shoqërimin e vlerave monetare të FSHU, Drejtoria Rajonale Burrel të KNK-ve dhe Arkave sipas Tabelës së *Shtojcës 6*.

Ruajtja dhe shoqërimi i vlerave monetare të mbledhura nga KNK dhe Arkat do të bëhet çdo ditë nga e Hëna në të Shtunë nga vendndodhja e KNK dhe Arkave deri në bankat respektive të qyteteve me të cilat ka kontratë FSHU-ja.

Gjithashtu, Ofruesi i Shërbimit do të sigurojë ruajtjen fizike të punonjësve të KNK dhe arkave (arkëtarët) gjatë kohës që ata janë duke performuar detyrat e tyre në ambientet e FSHU, Drejtoria Rajonale OSSH, Burrel, si dhe gjatë transportit të vlerave monetare deri në përfundim të dorëzimit të këtyre vlerave pranë bankave respektive.

**Çdo punonjës i shërbimit, titullari i subjektit të SHPSF-së, si dhe drejtuesi teknik duhet të kryejnë me përgjegjësi të gjitha detyrat e përcaktuara në Ligjin Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” të publikuar në fletoren zyrtare date 08.08.2014, si dhe në aktet nënligjore.**

#### **Shpërndarja**

Kërkohet Shërbimi sipas *Shtojcës 6*.

#### **Koha e Shërbimit:**

Turn i parë nga ora 14.<sup>00</sup> - 16.<sup>00</sup>. Turn i dytë nga ora 20.<sup>00</sup> - 21.<sup>00</sup>.

#### **Vendi i kryerjes së shërbimeve:**

Do të bëhet në vendndodhjen e KNK-ve dhe Arka-ve sipas *Shtojcës 6*.

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

---

## **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

**SHËNIM:** Operatorët ekonomikë krahas Formularit të Ofertës dhe preventivit të publikuar në DST duhet të paraqesë edhe:

- Analizën e Çmimit me përlllogaritje konkrete aritmetike, në të cilën të jenë përfshirë të gjitha detyrimet ligjore si:
  - Shpenzime për pagë bazë,
  - Shtesë mbi pagë për turnin II,
  - Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%,
  - Shpenzime administrative të shoqërisë
  - Karburant për Autoblindat
  - Taksat e Siguracionet e Autoblindave
  - Mirmbajtje të Autoblindave
  - Shpenzime për Autorizimet e Autoblindave
  - Fitimi i shoqërisë.

Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit dhe analizes se kostos, rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka të drejtë t'u kërkojë operatorëve ekonomik sqarime në lidhje me zërat e ofertës ekonomike dhe në rast se konstaton se operatori nuk e argumenton dot aritmetikisht, ligjërisht dhe me dokumentacion mbështetës ofertën, autoriteti do ta skualifikojë.

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

---

## 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- 2.1.1 Liçensë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “Shërbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”, **nënkategoria 1.3.B**, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike dhe transport vlerash monetare”, lëshuar nga QKL/ QKB;
- 2.1.2 Çertifikatë e drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për **nënkategorinë 1.3.B** i pajisur edhe me çertifikatë trajnimi për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë lëshuar nga subjekte të akredituar sipas ligjit.
- 2.1.3 Operatori ekonomik të disponojë Nipt Kryesor në qytetin Peshkopi dhe Lezhë për operatorët që kanë selinë kryesore në këtë qytet dhe Nipt Sekondar për operatorët që kanë selinë kryesore në një vendodhje tjetër.

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021, dhe 2022** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet.  
*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*
- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020, 2021, dhe 2022**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.  
*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*
- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2023** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 të DST-së.  
*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

## 2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

---

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

*Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh ekonomik, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë akt – marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik, si dhe në rast se është realizuar si nënkontraktor duhet të paraqesë miratimin e autoritetit kontraktor.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **30 (tridhjetë) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku të përfshihet edhe Drejtuesi Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 9 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues, duhet që në stafin teknik të ketë edhe **1 (një)** punonjës i diplomuar për *Elektronik/ Telekomunikacioni/ Informatik*, i trajnuar dhe i certifikuar nga një prej prodhuesve të sistemeve elektronike për të instaluar dhe mirëmbajtur këto sisteme elektronike, me qëllim mirëmbajtjen e sistemit elektronik të sallës operative. Për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: Diplomë, Çertifikatë e trajnimit nga Prodhuesi, Kontratën e Punës e cila duhet të mbulojë të gjithë periudhën e shërbimit, si dhe të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.2.

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të plotësojë këtë kriter në të kundërt përbën kusht për s'kualifikim.*

2.3.4 Me qëllim parandalimin e zjarreve dhe trajnimit të punonjësve të shërbimit, për shkak se: - *Kanë rëndësi të veçantë në ruajtjen dhe shoqërimin e vlerave monetare në KNK, Arka etj. Janë objekte me vendndodhje në zona me objekte të shumta e të dendura banimi*, operatori ekonomik ofertues duhet që në stafin e tij të ketë **1 (një)** Ekspert privat Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes

---

nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 2 të nenit 34 të ligjit nr.8766, datë 05.04.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”.

Për të përmbushur këtë, operatori ekonomik duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: Liçencë kodi I.2A të lëshuar nga QKL/QKB, Kontrat Pune, Leje për ushtrimin e profesionit lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme/ Drejtoria e PMNZSH, si dhe të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.2.

Për operatorët ekonomik që nuk kanë në staf Ekspertin, duhet të paraqesin:

- Kontratë shërbimi nënshkruar me Ekspertin të liçencuar për këtë lloj shërbimi;
- Liçencë kodi I.2A të lëshuar nga QKL ose QBK,
- Leje për ushtrimin e profesionit lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme/ Drejtoria e PMNZSH

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, kriteri duhet të përmbushet nga secili prej operatorëve ekonomik në të kundërt përbën kusht për s’kualifikim.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të zotërojë Liçencë/ Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” me zonë mbulimi Qarkun Dibër dhe Qarkun Lezhë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se muaji **Maj 2023**, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së **Qarkut Dibër**, me anë të cilit të jepet *informacion* për:

- Jo më pak se **1 (një)** përgjegjës shërbimi,
- Arme krahu **3 (tre)** copë,
- Arme Brezi **3 (tre)** copë,
- Jo më pak se **6 (gjashtë)** punonjës shërbimi të pajisur me autorizim për të mbajtur armë,
- Grup të gatshëm,
- Qendër Kontrolli në qytetin Peshkopi (*Sallë Operative*),
- Nuk janë dhënë masa administrative për vitet 2021-2022,
- Ka punuar mirë gjatë ushtrimit të aktivitetit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se muaji **Maj 2023**, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së **Qarkut Lezhë**, me anë të cilit të jepet *informacion* për:

- Jo më pak se **1 (një)** përgjegjës shërbimi,
- Arme krahu **2 (dy)** copë,
- Arme Brezi **2 (dy)** copë,
- Jo më pak se **4 (katër)** punonjës shërbimi të pajisur me autorizim për të mbajtur armë,
- Grup të gatshëm,
- Qendër Kontrolli në qytetin Lezhë (*Sallë Operative*),
- Nuk janë dhënë masa administrative për vitet 2021-2022,
- Ka punuar mirë gjatë ushtrimit të aktivitetit.

---

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt-Miratim për Qendrën e kontrollit në qytetin e Peshkopisë dhe Lezhës të vlefshme në datën e hapjes së tenderit, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër dhe Lezhë në përputhje me Kreu VII, pika 5, i Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht **5 (pesë) automjete** dhe **2 (dy) motorra** në emër të shoqërisë, ose të marra me qera nga një person juridik apo fizik tjetër, ku të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Për automjetet në pronësi duhet të paraqiten:

- Lejet e qarkullimit.
- Çertifikatë e kontrollit Teknik
- Taksat e paguara.
- Siguracionet

Për automjetet me qera duhet të paraqiten:

- Kontratë qeraje noteriale
- Çertifikatat e Pronësisë
- Lejet e qarkullimit.
- Çertifikatë e kontrollit Teknik
- Taksat e paguara.
- Siguracionet
- Faturat tatimore të prera nga qiradhënësi dhe pagesën përkatëse bankare për periudhën e marrjes së mjeteve me qera

Disponimi i automjeteve/ motorrave do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë **5 (pesë) Autoblinda** të Llojit APV, minimalisht kategoria FB3, në emër të shoqërisë, ose të marra me qera nga një person juridik apo fizik tjetër, ku të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm.

Për automjetet në pronësi duhet të paraqiten:

- Autorizim Blindi nga Drejtoria e Pergjitheshme e Policise se Shtetit;
- Çertifikatat e Pronësisë
- Lejet e qarkullimit.
- Çertifikatë e kontrollit Teknik
- Taksat e paguara.
- Siguracionet

Për automjetet me qera duhet të paraqiten:

- Kontratë qeraje noteriale
- Çertifikatat e Pronësisë
- Autorizim Blindi nga Drejtoria e Pergjithshme e Policisë së Shtetit në emër të qeramarrësit;
- Lejet e qarkullimit.



- 
- *Çertifikatë e kontrollit Teknik*
  - *Taksat e paguara.*

Disponimi i autoblivdave do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

2.3.11 Me qëllim funksionimin e Sallave Operative **24 orë në 24 orë** pa ndërprerje, Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht **2 (dy)** gjenerator rezervë me jo më pak se 30 KWA, me qëllim furnizimin e sallave me energji në rast ndërprerje të saj.

Në rast se gjeneratorët janë **në pronësi**, operatori duhet të paraqesë:

- *Fatura Tatimore Shitje, dhe/ose*
- *Kontratë Shitblerje, dhe/ ose*
- *Kontratë Dhurimi, dhe/ose*
- *Deklaratat zhdoganimi për të gjitha rastet duhet të paraqitet dhe fatuara e pagesës për sendin, duke përjashtuar rastin e dhurimit.*

Në rast se gjeneratorët **nuk janë në pronësi**, operatori duhet të paraqesë:

- *Kontrata e lidhur përpara noterit për marrjen në përdorim të sendit për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.*
  - *Fatura Tatimore të Shit-blerjes së sendit, dhe/ose*
  - *Deklaratën e zhdoganimit.*
- Për operatorët ekonomik që nuk disponojnë gjenerator, duhet të paraqesin Bateri dhe/ose UPS që garantojnë furnizimin me energji të Qendrës së Kontrollit për jo më pak se 12 orë në përputhje me nenin 22 të ligjit Nr.75/2014. Për të përmbushur këtë kriter, operatorët duhet të paraqesin:

Në rastet kur pajisja është **në pronësi**, operatori duhet të paraqesë:

- *Fatura Tatimore Shitje e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji dhe/ose*
- *Kontratë Shitblerje e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji dhe/ose*
- *Deklarat Zhdoganimi e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji*
- *Për të gjitha rastet duhet të paraqitet edhe fatura e pagesës për sendin.*

Në rastet kur pajisja **nuk është në pronësi**, të paraqitet:

- *Kontrata e lidhur përpara Noterit për marrjen në përdorim të sendit për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji.*
- *Faturën tatimore të shitblerjes së sendit e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji dhe/ose*
- *Deklaratën e zhdoganimit e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji.*

---

Disponimi i pajisjeve do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

